

AKT -THEMELIMI

I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date _____, ne baze te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shtetore ne shoqeri tregtare", ndryshuar me Dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.03.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996, Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit

VENDOSI:

1. Te krijoje shoqerine anonime "Anijet e Sherbimit Detar" Durres Sh.A.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete :
 - Marrja e praktikave te anijeve ne mbritje (rade) transportimi i grupit te praktikes (autoritet portuale).
 - Transportuesi i ekuipazhit te anijeve, udhetareve nga rada ne port e anasjelltas.
 - Kryerja e sherbimeve brenda akuatoriumit te portit.
 - Kryerja e sherbimit rimorkiator anijeve si gjate akostim-çakostimit me detare ne raste avarije (defekti ne det) e tjera ne perputhje me konventat detare nderkombetare.
 - Kryerja e sherbimit te ngarkimit- shkarkimit te mallrave me peshe te rende deri 100 ton. me ndihmen e vinxhit lundrues.
 - Furnizimin me uje te embel te anijeve shqiptare e te huaja sipas kerkesave te tyre.
 - Germimin (thellimin), mirembajtjen e kanaleve hyrse, akuatoriumeve, kalatave te porteve detare, tregtare e jocivile te Shqiperise, dhe ne raste te veçanta per te tretet (te huaj).
 - Kryen sherbime polumbare per kontrollin e objekteve te nenujshme.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne Durres dhe ajo mund te cele dege, filiale, agjensi dhe perfaqesi ne te gjithë territorin e Republikes se Shqiperise dhe me miratimin e organeve kopetente edhe jashte shtetit.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 111.922.000 leke i ndare ne 111.922 aksione me vlere nominale 1000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.

6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :

- Liljana PETROMILO
- Engjellushe ÇALI
- Arben MALOKU

7. Ndertimi, organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.

8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themeluese.



STATUT

I SHOQERISE ANONIME

NENI 1 Emertimi dhe selia

Shoqeria anonime krijohet nga transformimi i ndermarrjes shteterore Anijet e Sherbimit Detar Durres.

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A "Anijet e Sherbimit Detar" Durres.

Selia e shoqerise eshte ne adrese : Durres.

NENI 2 Objekti i shoqerise

Objekti i veprimtarise se shoqerise eshte :

- Marrja e praktikave te anijeve ne mbrritje (rade) transportimi i grupit te praktikes (autoritet portuale).
- Transportuesi i ekuipazhit te anijeve, udhetareve nga rada ne port e anasjelltas.
- Kryerja e sherbimeve brenda akuatoriumit te portit.
- Kryerja e sherbimit rimorkiator anijeve si gjate akostim-çakostimit me detare ne raste avarije (defekti ne det) e tjera ne perputhje me konventat detare nderkombetare.
- Kryerja e sherbimit te ngarkimit- shkarkimit te mallrave me peshe te rende deri 100 ton. me ndihmen e vinxhit lundrues.
- Furnizimin me uje te embel te anijeve shqiptare e te huaja sipas kerkesave te tyre.
- Germimin (thellimin), mirembajtjen e kanaleve hyrse, akuatoriumeve, kalatave te porteve detare, tregtare e jocivile te Shqiperise, dhe ne raste te veçanta per te tretet (te huaj).
- Kryen sherbime polumbare per kontrollin e objekteve te nenujshme.

1


Shoqeria brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe financiar qe lidhet drejteperdrejte ose terthorazi me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimtarive dhe krijimin e shoqerive te reja si dhe pjesemarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera brenda dhe jashte vendit.

NENI 3

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 111.922.000 leke. Numri i aksioneve eshte 111.922. Vlera nominale e aksionit eshte 1000 leke.

NENI 4

Transferimi i aksioneve ne rast privatizimi

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me Urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

NENI 5

Organet drejtuese te shoqerise

Organet drejtuese te shoqerise jane :

- 1) Keshilli mbikqyres
- 2) Drejtoria

NENI 6

Keshilli Mbikqyres

- Keshilli mbikqyres perbehet nga 3 (tre) anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.



- Kohezgjatja e funksionit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithë te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar per shkaqe te perligjura.
- Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Ata nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.
- Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se 3 (tre) muaj. Anetari i keshillit mbikqyres i emeruar me zevendesim te nje anetari tjetër, perfundon mandatin e paraardhesit..
- Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 (gjashtedhete e pese) vjeç nuk mund te jene me shume se 1/3 (nje e treta) e numrit te pergjithshem te keshillit mbikqyres. Ne se ky raport tejkalohet anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

NENI 7

Kryetari dhe zevendes kryetari i keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendes kryetar, te cilet therresin mbledhjen e keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata zgjidhen per te gjithë kohen e mandatit te tyre dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te ngarkoje nje person si sekretar edhe jashte anetareve te tij.

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit, mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga zevendes kryetari.

NENI 8

Vendimet e keshillit mbikqyres

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interesi i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendes kryetarit. Kryetari duhet te therrase mbledhjen e keshillit mbikqyres brenda 15 (pesembedhete) diteve kur drejtoria ose 1/3 (nje e treta) e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkese te motivuar per kete qellim. Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere anetaret mund te therrasin mbledhjen e keshillit mbikqyres, duke i percaktuar rendin e dites. Ne parim thirrja duhet te behet 3 (tre) dite perpara, me leter, telegram, teleks ose fax. Por thirrja mund te jete e vlefshme edhe me



goje dhe pa afat ne se anetaret e keshillit mbikqyres do ta pranojne ate. Çdo thirrje duhet te percaktoje rendin e dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres zhvillohet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te percaktuar ne thirrje. Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem vetem ne se jane te pranishem jo me pak se gjysma e anetareve te tij. Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem, ne rast barazimi votash, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

Keshilli mbikqyres mban nje regjister te pjesemarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkruhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje. Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari dhe nje anetar i keshillit ose ne mungese te tij, nga dy anetare te keshillit mbikqyres.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zevendeskryetari i keshillit mbikqyres.

NENI 9

Kompetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emerone drejtorine. Keshilli mbikqyres cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontrole qe ia i çmon te pershtatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.
- Drejtoria i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj. Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financiar drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres i propozon Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :

4


- a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
- b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financiar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- c) Hapjen e veprimtarive ose njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
- d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
- e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarrjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
- f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjate.
- g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze të ligjit “Per shoqerite tregtare” eshte kompetence e Asamblese së Pergjithshme.

NENI 10

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

NENI 11

Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria e cila mund te perbehet nga nje ose disa anetare. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres me nje vendim te tij.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithë anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtore ose drejtor ne me shume se nje shoqeri. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te

5


perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.

- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhete e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhete e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.

NENI 12

Kompetencat e drejtorise

- Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoqerise.
- Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruara nga anetari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin e veprimtarise se shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercente objektin e veprimtarise se shoqerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke pasur parsysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e anetareve te saje. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- Marredheniet brenda shoqerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.

6


NENI 13

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetereve te drejtorise ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejteperdrejte ose jo e drejteperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshje. Kjo nuk eshte e zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

NENI 14

Eksperti kontabel i autorizuar

Kontrolli i shoqerise ushtrohet nga 1 (_nje_) eksperte kontabel te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajttesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

NENI 15

Ushtrimi financiar

Ushtrimi financiar fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Perjashtimisht ushtrimi i pare financiar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar deri me 31 Dhjetor.

NENI 16

Inventari -llogarite vjetore

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitetit te rregullt te pasurise dhe te vperimtarise se saj ne pajtim me kerkesat ligjore. Ne mbylljen te ushtrimit, drjtoria harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per

 :

ushtrimin financiar. Drejtoria pergatit gjithashtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit financiar.

NENI 17

Rezultati i ushtrimit dhe percaktimi i fitimit

Rezultati i ushtrimit percaktohet si difference ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem.

Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsye çfaredo, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit.

Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

NENI 18

Emerimi i anetareve te pare te keshillit mbikqyres

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen :

- Liljana PETROMILO
- Engjellushe ÇALI
- Arben MALOKU

NENI 19

Emerimi i ekspertit kontabel te pare te autorizuar

Ekspert i (te) pare kontabel i (te) autorizuar emerohet (n) :

- 1) Z. Marie DUSHI.

NENI 20

Asambleja e pergjithshme

Te gjitha kompetencat e asamblese se pergjithshme te parashikuar nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne



kete statut, ushtrohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine aksionerit te vetem.

NENI 21
Dispozita te fundit

Ne nje afat prej 6 (gjashte) muajsh nga data e rregjistrimit te shoqerise ne regjistrin tregtar, drejtori i shoqerise do te jete drejtori i ish-ndermarrjes shteterore. Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit veç per shkaqe te perligjura.

NENI 22

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut, i referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

ZV. MINISTRI
relly
PAJTIM BELLO

